

L I G J
PER PLOTESIMIN E LIGJIT PER QEVERINE E REPUBLIKES SE MAQEDONISE

Neni 1

Ne Ligjin per Qeverine e Republikes se Maqedonise ("Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 59/2000, 12/2003, 55/2005 dhe 37/2006), ne nenin 40-a shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Informimin e rregullt te opinionit publik per punen e Qeverise edhe per konkluzionet e miratuara, e kryen zedhenesi i Qeverise se Republikes se Maqedonise, te cilin e emeron dhe shkarkon Qeveria."

Neni 2

Pas nenit 40-b shtohet neni i ri 40-v si vijon:

"Neni 40-v

(1) Per kryerjen e puneve te lidhura me zbatimin e Marreveshjes kornize dhe sigurimin e koordinimit te organeve te administrates shteterore, si dhe per kryerjen e puneve te tjera profesionale nga kjo lemi, formohet Sekretariati per zbatimin e Marreveshjes kornize.

(2) Sekretariati per zbatimin e Marreveshjes kornize i kryen punet te cilat kane te bejne me sigurimin e koordinimit dhe harmonizimin e puneve te organeve te administrates shteterore per zbatimin e Marreveshjes kornize; sigurimin dhe koordinimin e perkrahjes se Qeverise ne realizimin e prioritetit strategjik te nderlidhur me obligimet te cilat dalin nga Marreveshja kornize, e vecanerisht per sigurimin e perfaqesimit te drejte dhe perkates te qytetareve te cilet u takojne te gjitha bashkesive ne organet e administrates shteterore; e siguron dhe koordinon pergatitjen e metodologjise per miratimin e planeve aksionare te Qeverise ne lemin e zbatimit te Marreveshjes kornize; e siguron dhe koordinon perpunimin e Planit aksionar per pergatitjen e projekteve nga Marreveshja kornize dhe koordinimin e zbatimit te tij dhe percjelljen e tyre; rregullisht komunikon dhe ben koordinime per realizimin e detyrave te ndermarra ne baze te projekteve nga planet aksionare nga ministrite perkatese; ben koordinimin e aktiviteteve me organet e administrates shteterore dhe me donatoret; siguron qasje koherente per shtimin e efikasitetit te procesit te zbatimit te Marreveshjes kornize; punon ne sigurimin e resurseve te nevojshme njerezore per realizimin e procesit te zbatimit te Marreveshjes kornize; angazhohet per sigurimin dhe realizimin e mjeteve te nevojshme financiare per zhvillimin me sukses te procesit te realizimit te obligimeve te cilat dalin nga Marreveshja kornize ne kuader te Buxhetit te Republikes se Maqedonise dhe nga donatoret; mban komunikim me opinionin publik dhe me grupe tjera qellimore nepermjet medimeve dhe kujdeset per azhurnimin e veb-faqes; pergatit raporte per informimin e Qeverise per nivelin e zbatimit te Marreveshjes kornize; per nevojat e Qeverise pergatit materiale profesionale-analitike nga kjo lemi; jep mendim profesional per materialet te cilat jane ne funksion te zbatimit te Marreveshjes kornize; si dhe pune te tjera te lidhura me zbatimin e Marreveshjes kornize te cilat do t'i percaktoje Qeveria.

(3) Me Sekretariatin per zbatim e Marreveshjes kornize udheheq anetari i Qeverise i obliguar per zbatimin e Marreveshjes kornize, i cili i ka te drejtat dhe obligimet e funksionarit, i cili udheheq me organin e administrates shteterore."

Neni 3

Ne nenin 42 pas fjaleve: "Sekretariati per ceshtje evropiane" vihet presje dhe shtohen fjalet: "Sekretariati per zbatimin e Marreveshjes kornize".

Neni 4

Sekretariati per zbatimin e Marreveshjes kornize, aktet e reja per organizimin dhe sistematizimin e vendeve te punes, ne pajtim me ligjin, do t'i miratoje ne afat prej 30 ditesh prej dites se hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Te punesuarit ne Sektorin per zbatimin e Marreveshjes kornize ne Sekretariatin e pergjithshem vazhdojne me pune ne Sekretariatin per zbatimin e Marreveshjes kornize ne pajtim me Ligjin per nepunes shteterore. Pajisjen, inventarin, dokumentacionin dhe mjetet e punes se Sektorit per zbatimin e Marreveshjes kornize, i ndermerr Sekretariati per zbatimin e Marreveshjes kornize.

Neni 5

Ky ligj hyn ne fuqi dite e tete prej dites se shpalljes ne "Gazeten zyrtare te Republikes se Maqedonise".

